



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 88/2017

Prishtinë, më 28.2.2017, në orën 12:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Raif Qela, Sala Berisha- Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Rustem Berisha dhe Enver Hoti.

Munguan: Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Sasha Milosavljeviq, zëvendëskryetar i dytë, Besim Beqaj dhe Duda Balje, antarë.

I ftuar: Abdullah Hoti, ministër i Financave.

Pjesëmarrës të tjerë: Artë Kastrati dhe Muharrem Shahini – Ministria e Financave; Dardan Abazi – INDEP, Etleva Malushi – LVV, Blerta Aliu – KDI, Besim Toska – Gazetar, Albulena Avdiu – Ekonomia Online, Albulena Mavraj – Epoka e Re, Selim Thaçi – IMF, Semra Çitaku – Ambasada Britanike në Kosovë, Bujar Treni – RTV21, Pranvera Musa – KTV, Kushtrim Ahmeti – KTV, Driton Vitia – Kosova Sot dhe Lumnije Bekaj – Kosova Info.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Veton Raci, si dhe Leutrim Krasniqi e Erëza Hasani, praktikantë të Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.2.2017;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
4. Prezantim i Pakos së dytë Fiskale nga minsitri i Financave, z. Abdullah Hoti;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Raif Qela propozoi te pika e rendit të ditës “Të ndryshme” të futet në rend dite edhe çështja e vendimit të Komisionit të Konkurencës lidhur me Postën, si dhe lidhur me problemin e ndërprerjes së energjisë elektrike për disa biznese, dhe kjo të behët pa praninë e mediave.

Kryetari tha se nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë në vendimet e Komisionit të Konkurencës, për këtë i kemi sugjeruar edhe përfaqësuesit e Postës në një takim që kemi pasur, që ata t’i drejtohen gjykatave kompetente, diskutimi ynë për këtë çështje do të vije në rend dite nëse konstatojmë se Komisioni ka bërë ndonjë shkelje të ligjit. Kurse për çështjen e ndërprerjes së energjisë elektrike për bizneset keni të drejtë, por këtë do ta diskutojmë kur të kemi informacionin e plotë nga ZRRE-ja.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.02.2017

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 21.02.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryetari tha se ky ndryshim i këtij projektligji ka ardhur me propozim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mënyrë që të racionalizohen shpenzimet e buxhetit të kësaj agjencie lidhur me kontestet pranë Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, Komisioni e ka mirëpritur këtë propozim dhe vitin e kaluar kemi marrë nismë legislative për ta plotësuar ligjin në fuqi. Sipas këtij ligji, pra ligjit mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, duhet patjetër të jetë një avokat i regjistruar në Odën e Avokatëve si përfaqësues i Agjencisë. Agjencia ka një shërbim juridik mjaft të kualifikuar dhe paguhet për t’i mbrojtur interesat e agjencisë, kështu që duhet të ndryshojë ai nen.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, më 28.02.2017, e shqyrtoi Projektligjin nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, pa amendamente.

4. Prezantim i Pakos së dytë Fiskale nga minsitri i Financave, z. Abdullah Hoti

Kryetari tha se, siç e dini, në mbledhjen paraprake kemi diskutuar që është më mirë që të informohemi në mënyrë më të detajizuar në lidhjen me përmbajtjen e “Pakos së dytë fiskale” me

të cilat Ministria e Financave dhe ministrinë e tjera kanë zhvilluar një aktivitet të ngjeshur këta muajt e fundit në konsultime me bizneset dhe me asociacionet e bizneseve. Ne kemi marrë një sërë diskutimesh në lidhje me avancimin e mjedisit ku politika fiskale e ka një rëndësi tejjet të madhe dhe për këtë sot e kemi fuar z. ministër, ku ndoshta ndonjë anëtarë i Komisionit ka ndonjë ide apo sugjerim që të pasurohet kjo pako para se të aprovohet në Qeveri.

Abdullah Hoti, ministër i Financave, i falendëroi deputetët dhe Komisionin për ftesën dhe mundësin e dhënë për ta paraqitur “Pakon e dytë fiskale”. Në diskutimet për këtë pako i kemi filluar në shtator të vitit të kaluar me komunitetin e biznesit, ku në fund të vitit, në muajin dhjetor një draft të parë - inicial - e kemi aprovuar në Qeveri formalisht dhe me miratimin e Qeverisë kemi filluar debatin me të gjitha Odat, Shoqatat e Biznesit të gjitha pa përjashtim. Lista iniciale ka qenë prej 7 (shtatë) masave tani është rreth 20 (njëzet) masa të ndryshme. Shumica e masave të propozuara involvojnë ndryshimin e propozimeve administrative, vendimeve të ndryshme ekzekutive të Qeverisë ose të trupave rregullative nëpër institucionet e ndryshme. Në masë të madhe kjo pako fiskale komplementon pakon fiskale të shtatorit 2015 dhe zhvillon metodime kështu që me këto masa pothuajse përmbyllet reforma sa i përket ligjeve, rregullave që përcaktojnë politikën fiskale dhe mandej mbetet çështje e rritjes së efikasitetit institucional për përmirsimin e kushteve të të bërit biznes.

Masat e papara me këtë pako fiskale janë si më poshtë:

- Masa e parë, është zgjerimi i listës së produkteve që konsiderohen si lëndë e parë për lirim nga tatimi doganor, këtu po mundohemi që ta aprovojmë listën e prodhuesve vendor dhe për ata prodhues vendor të vlejë të gjitha lirimet për lëndët e para, ku unë mendoj dhe besoj që kjo do të ndikojë dukshëm në uljen e kostos së prodhimit duke i bërë bizneset vendore më konkurente në tregun vendor deri në atë tregun ndërkombëtar. Kjo masë do të zbatohet përmes nxjerrjes së një udhëzimi të ri administrativ për mallrat e liruar nga tatimi doganor që derivon nga Ligji përkatës.
- Masa e dytë, është heqja e normës së akcizës me mazut, të cilën neve me vendimin e vitit 2015 të Qeverisë e kemi liruar në fakt nga akciza, por është dashur në faktë që në fillim të paguajnë akcizën që të rinburosohen kur të dokumentohen për qëllim prodhimi.
- Masa e tretë ka të bëjë me ndryshimin dhe plotësimin e listës së produkteve që i nënshtrohen normës së reduktuar 8% të TVSH-ës. Kemi disa analiza dhe disa orientime të cilat po e përkrahin sektorin e turizmit, hotelierive, kulturën, sportin dhe disa shërbime të ndryshme, kështu që të zvoglojmë TVSH-në për produkte të cilët janë të afruar për sektor për të rritur kërkesën për këto produkte dhe shërbime, për të nxitur zhvillimin e bizneseve nga këta sektorë.
- Masa e katërt, është udhëzimi administrativ për pushimet tatimore që derivon nga Ligji për të ardhurat e korporatave, një draft të këtijë udhëzimi e kemi të gatshëm ku ka një kohë, por jemi në konsultimin me Fondin Monetar Ndërkombëtar, meqenëse ky udhëzim bashkë edhe me masat e tjera prodhojnë implikime buxhetore dhe ne duhet t'i balancojmë këto me efekte ekonomike të cilat krijohen në ekonomi.
- Masa tjetër është vendosja e banderollave, në produktet e miellit që importohen në Kosovë, jo për qëllime fiskale, por për qëllime të cilësisë së produktit të mirë që është në qarkullim edhe për qëllim të formalizimit të sektorit në bazë të analizave që edhe vetë Oda Ekonomike e Kosovës ka treguar që informaliteti në këtë sektorë është bukur i madh.
- Masa tjetër ka prapë të bëjmë me një akt nënligjor për evidentimin dhe pranimin e humbjeve nga prishja, avullimi apo humbja në peshë e derivateve dhe e produkteve gjatë procesit të dregtimit vendor.

- Një masë tjetër të cilën po e planifikojmë me e ndërmarr është me shumë reformen administrative, është krijimi i listës së raitingut të kompanive vendore, pra një liste të kompanive vendore dhe ndërkombëtare të cilat janë të rregullta plotësisht në kryerjen e obligimeve ndaj administratës tatimore, doganës dhe ndaj institucioneve të tjera, të cilat kompani do të kenë trajtim profesional kur kanë të bëjnë me institucionet publike. Në ATK, ne veç e kemi hapur një sportel të tillë ku ndërmarrjet të cilat e marrin shenjen që janë të rregullta me kryerjen e obligimeve të tyre mund t'i kryejnë të gjitha procedurat që i kanë pa vonesë.
- Një masë tjetër e cila është me shumë rëndësi është rritja e transparencës edhe efikasiteti i procedurave për lëshimin e licencave të të gjithave llojeve, qoftë edhe në transport, miniera apo edhe në sektorë të ndryshëm.
- Masa që ka të bëjë me fiskalizimin - më lejoni që t'iu them se neve kemi bërë një proces bukur të madh, sidomos në dy vitet e fundit, në fiskalizim dhe të hyrat buxhetore janë rritur dukshëm, por ka hapësirë ende, por sivjet po planifikojmë që ta ndrojmë mënyrën e fiksalizimit duke vendosur arka fiskale dhe duke i ndërlidhur ato online me ATK-në. Jemi në grup të ngushtë me ministrin e Financave të Kroacisë për ta adaptuar procesin e tyre fiskal edhe në Kosovë. Do të hyjmë procesit të rishikimit të Projektlgjit për lojërat e fatit për ta rregulluar këtë sektor.
- Një masë tjetër është rregullimi i çështjes së transportit rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve. Këtu duhet të ndryshojë Ligji për TVSH-në për t'ju mundësuar kompanive të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve rimbursimin e TVSH-së për shpenzimet të cilat i bëjnë.
- Një masë tjetër teknike ka të bëjë me trajtimin e telefonisë mobile, treg i cili është në hov të madh dhe në rritje dhe që është në pjesën më të madhe i pa formalizuar. Këtu në fakt e kemi të përgaditur bazën ligjore me një udhëzim administrativ i cili i detyron dy kompanitë e telefonisë mobile që mos t'i aktivizojnë aparatet e telefonisë mobile nëse nuk është kryer pagesa dhe faturimi doganor për ato paisje, por që është stopuar për një çështje të ruajtjes të të dhënave apo privatësisë së të dhënave.
- Një masë tjetër që është propozuar nga komuniteti i biznesit, Aleanca Kosovare e Biznesit veç është, trajtimi i pijeve të gazuara dhe jo të gazuara, momentalisht bizneset të cilat janë në këtë sektor paguajnë 4.5 centë për liter të pijeve të cilat nuk janë natyrale, pra pije të gazuara.
- Një masë tjetër e cila do të ndërmerret nga Dogana është rregullimi i shitjeve online që prapë është në treg në rritje.
- Masë tjetër që do të ndërmerret nga një udhëzim administrativ ka të bëjë me rregullimin e importit parcial të makinerive, kjo lidhet me pakon fiskale të vitit 2015.

Kryetari: E falenderoi ministrin për prezentimin prezentimin detal. Po konstatoj me kënaqësi se është rritur numri i masave, kjo do të thotë që ju po reagoni pozitivisht në propozimet e asociacioneve të biznesit, e që është një faktor shumë pozitiv për arsye se keni dëgjuar me durim komunitetin e biznesit dhe natyrisht që ajo ka një rëndësi esenciale dhe, natyrisht që komuniteti i biznesit vazhdimisht ka kërkesa për uljen e taksave, por neve, si Kuvend dhe si Qeveri, duhet me u kujdes edhe për anën tjetër edhe për stabilitetin buxhetor. E dyta, ajo që unë po e konstatojmë me kënaqësi, është që të gjitha këto masa janë të lidhura me nxitje të investimeve. Kështu që ne me vite kemi kërkuar që këtë TVSH-në, që mos me u paguar në kufi, që Dogana filloj të hiqet dhe këtë e kemi arritur me pakon fiskale një. Tash po e zgjerojmë edhe listën e lëndëve të para, të materialve për prodhuesit vendorë dhe që është pozitive.

Raif Qela tha se pavarësisht që nuk kemi ndonjë institucion që do të ishte konsideruar mjaft i besueshëm për statistikën, megjithatë rezultatet e para flasin se ka levizje pozitive në drejtim të asaj

që përmes pakos së parë fiskale ka filluar të krijohet ambient më i volitshëm për bizneset edhe për zhvillim ekonomik të Kosovës. Uroj që edhe pakoja e parë fiskale edhe pakoj e dytë e cila është në procedurë të ketë sukses edhe me këtë të ketë sukses edhe Qeveria, sepse suksesi i Qeverisë së Kosovës është suksesi i Kosovës, pavarësisht se kush e udhëheq apo është në Qeveri. Një çështje që për mua është mjaft me rëndësi, ku për të tjerët mund të mos jetë shumë e listës për plotësim dhe ndryshim të produkteve që janë nënshtruar normës zero, mendoj që duhet t'i shtohet edhe libri. Duke e pasur parasysh në rend të parë arsimimi edhe edukimi është ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit, mendoj që librin duhet ta heqim nga tatimi nga çdo lloj i taksës, përveç atij lloj tatimit në fitim. Kjo për arsyen e thjeshtë sepse ne përmes kësaj do të nxisim dhe do ta stimulojmë leximin i cili është në rënie e sipër. Disa prej disa shteteve të botës tashmë një pjesë e kanë bërë, sidomos shtete skandinave dhe Kroacia e kanë të gjitha tatimin mbi vlerën e shtuar zero për librin. Kjo nuk është kushedi se çfarë përfitimi për buxhetin e shtetit nëse heqet tatimi mbi vlerën e shtuar për librin, ndërsa fitimet afatgjate do të jenë shumë të mëdha. Gjermania gjatë revolucionit të vitit 1848 -1851 ka qenë në bisht të Evropës sa i përket zhvillimit ekonomik për Evropën për shkak se kanë investuar shumë në arsimim, edukim, ku pas disa dekatave është bërë superfuqi botërore. Andaj i propozoj ministrit që në listën e produkteve që i nënshtrohen normës zero të futet edhe libri edhe produktet e përafërta me librin.

Blerim Grainca tha se ashtu siç e kanë diskutuar edhe me komunitetin e biznesteve edhe me të tjerët t'i propozojë që në këto masa të futet edhe lirimi i gasit nga akciza, gasit ELPJ, sepse është gas që përdoret edhe për amvisëri edhe për industri. Arsyetimin tim e bazoj në faktin nga të dhënat të cilat i kam marrë nga Dogana janë paguar 9 milionë. Qeveria ka regjistruar 9 milionë të hyra akciz me gas dhe duke e pasur parasysh se kjo ka ndikim direkt në jetën e qytetarëve në koston apo në atë pakon familjare të familjeve tona kosovare. Mendoj që është e udhës që gasi të hiqet të lirohet nga akciza në mënyrë që kostoja e jetesës për qytetarët të jetë më e ulët. Prandaj gasi është mjaft ekologjik dhe nuk ka impakt në ambient, po ashtu kjo do të mundësonte edhe ruajtjen nga shkatërrimi i pyjeve tana për arsye siç e dini në Kosovë është një dukuri mjaft e theksuar shkatërrimi i pyjeve. Unë besoj që Ministria e Financave do ta ketë parasysh këtë propozim gjatë diskutimeve që të diskutojë dhe të harmonizojë edhe nga komunitetet të tjera të cilat prekën nga kjo në mënyrë që të kemi një pako më të kompletuar.

Fatmir Rexhepi tha se për sa kohë që po i përcjell strategjitë apo politikat të cilat kanë ardhur në Parlament mendoj që këto dy vitet e fundit nga strategjia të cilën e ka përcaktuar z. ministër në kuadrin e politikave të cilat i ka afruar edhe në pakon e parë por edhe në pakon e dytë, e cila ka të bëjë me pakon fiskale, mendoj që është mundësia maksimale dhe ajo e cila garanton një ambient shumë të favorshëm shumë më të përshtatshëm për prodhuesit vendorë, diçka që na ka munguar, diçka që e ka rënduar sektorin privat për me i zhvilluar, për me i rritur kapacitetet me i rrit investimet me e rritur konsumin, me e gjeneruar dhe me pas impakt në jetën ekonomike dhe me ngritje të buxhetit të vendit. Me këto masa shtesë të cilat i ka bërë Qeveria po mundohem që ta bëjë një krahasim praktik, ku jam shumë i sigurt se shumë kompani në Kosovë kanë me ndjerë për të mirë lehtësimin, sidomos me këto shtatë pika për të cilat u fol, që nga lënda e parë e deri tek ajo e fundit drejtëpërdrejt kanë me ndikuar në konkurrencë në kosotn e prodhimit të produkteve tona me ngritjen e cilësisë të produkteve marrin pjesë në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Pra, në eksport. Kjo është ajo formula të cilën, unë po mundohem me e lexuar brenda këtyre pakove. Pra, pa shtet të mirë, pa buxhet të mirë nuk ka as biznes të mirë, por kur nuk ka biznes të mirë nuk ka mundësi as buxheti të jetë i mirë. Kështu që unë pakon e lexoj në këtë drejtim dhe

apsolutisht ju përkrahi për këto synime për këto objektiva dhe sa më shpejt që këto të vendosen në jetën ekonomike të qytetarëve.

Enver Hoti: Ministri mori mjaft lavdata, besoj që sot nuk ka nevoj që të japim më shumë. Unë çka do të doja është që z. ministër që listën me këto masa që ta kemi edhe ne përpara do të ishte mirë si deputet t'i kemi. Ndërsa, pakoja fiskale ku mendoj që ngritja e TVSH-së në 18% ka vështirësuar shportën e konsumatorit, ku atëherë e patëm ngrit një amendament lidhur me këtë ku nuk e keni marrë parasysh, ndërsa në aspektin e klimës së krijimit të biznesit që u tha se është sjell ndonjë rezultat, lidhur me këtë nuk e kam ndonjë statistik. Klima e të bërit dhe e krijimit të biznesit nuk ka ndihmuar diçka përkundrazi është më e keqe se kurrë më parë nuk po them se për shkak të këtyre masave apo pakove fiskale por në përgjithësi të politikave të Qeverisë realizimi i bizneseve apo prurja e bizneseve të huaja është shumë e keqe. Edhe te kjo pakoja e dytë unë nuk po e shoh se e keni tërheq sektorin e industrisë së ndërtimit, që është njëra ndër ekonomitë më të mëdha, ku asnjë masë nuk po e shoh se e keni ndërmarrë për me e bërë një fiskalizim të kësaj pjese, por mund të them se ka shpërlarje të parave që krijohet nga bosët e mëdhenj të politikës dhe të kompanive të ndryshme të ndërtimit, të cilat ka argumente që qëndrojnë politikanë të mëdhenj pas tyre dhe juve nuk po guxonin as me ju qasur në pakon e juaj më këto masat fiskale, së paku me i futur në fiskalizim!

Rrustem Berisha tha se pa dyshim mendoj se këto masa do të ndikojnë pozitivisht në krijimin e një ambienti më të mirë për të bërë biznes, por ka edhe shumë të tjera që ndoshta është dashtë me punuar në atë drejtim që të formojmë një ambient shumë më të mirë dhe shumë më të përshtatshëm për biznes. U përmend këtu fiskalizimi, arkat fiskale, që do të merret praktika e Kroacisë. Unë mendoj që është kjo tepër e mirë, sepse duhet me e pasur parasysh te bizneset e vogla, sidomos te ato të cilat bëjnë një qarkullim ditor deri në 50 euro, cilat janë mundësit që ata munden që t'i blejnë arkat fiskale dhe ta paraqesin në mënyrë të qartë shitjen ose biznesin e tyre. Pastaj një çështje tjetër, ku mendoj se ish dashur që ta kemi parasysh, kemi të bëjmë më një ambient të sigurt për të bërë biznes. Ne e kemi pasur rastin në Prizren ku thuhet që argjendarët nuk e kanë sigurinë për të bërë biznes, ku aty mendoj se ndoshta do duheshin për të marrë masa shitesë. Ata e hapin lokalitë e fillojnë punën në orën 11 dhe e mbyllin para të gjithëve pikërisht për shkak të mos sigurisë të mjaftueshme. Problemi tjetër që mendoj se ka me ndikuar është tek ata të cilët e kanë bërë privatizimin, sidomos te tokat bujqësore të cilët nuk i punojnë. Ndoshta ishte dashur të këtë një informim që ato toka të ju kthehen punëtorëve dhe jo t'i marrin ata, vetëm t'i privatizojnë. Edhe çështja tjetër unë mendoj se duhet të gjendet një metodë që rolin e gruas ta avansojmë në biznes, gratë janë shumë më të kujdesëshme, janë shumë më të përpikta dhe duhet ta gjejmë një mënyrë që ta avancojmë këtë rol. Edhe lufta për me e hequr "cashin" prej dore, mendoj se do të zvoglonte në masë të madhe korrupsionin, për të cilin më mund me gjetur një formë qysh me eliminuar do ishte mirë.

Abdullah Hoti, ministër i Financave, tha se te çështja e librit është 8%, por është e zbritshme në vlerën paraprake dhe është më e favorshme për ndërmarrje për bizneset të cilat janë në këtë sektorë. Kështu që të gjitha blerjet paraprake kur i blejnë me TVSH duke qenë në këtë regjim të TVSH-së, duke qenë se unë bëjë blerje me 18%, ndërkaq libri ngarkohet me 8%, atyre nuk ju bie gati asnjëherë të paguajnë TVSH-në. Ndërkaq që gazetatat dhe mediat janë plotësisht të liruara matjes së TVSH me 8%, në pakon e parë fiskale, në shtator të vitit 2015, nuk e kemi mbajtur për qëllime tatimore pse nuk janë të rëndësishme nuk çojnë peshë TVSH- të të cilat ne i mbledhim

nga shitja e librit, por është në të mirë të sektorit në përgjithësi. E dyta do e diskutojmë çështjen e lirimit të gasit të cilën e parashtroj z. Grainca, që përdoret për qëllime të amvisënisë, obligimet buxhetore janë të konsiderueshme, por do të shohim se si do ta trajtojmë këtë çështje. Te ndërtimet, ne veç tani e kemi bërë një reformë, vendimet shpejguese të cilat i nxjerr administrata tatimore nga vitit i kaluar është bartur barra tatimore te ndërtuesi dhe është formalizuar sektori deri në fund sepse ke pasur katër, pesë kontrata të ndryshme në sektorin e ndërtimit për çfarëdo objekti, tash nuk shkojmë te secili prej tyre, por te ky i pari obligimet tatimore i merr i pari dhe rrjedhimisht është stabilizuar në mas të madhe ky sektor. Me artarët e kemi zgjidhur çështjen në mënyrë më të mirë të mundshme, e kemi aprovuar në vitin e kaluar me një udhëim administrativ që e konsiderojmë arin si diçka apo si valutë, si diçka të investueshme. Në fakt ne e aplikojmë vetëm obligimin doganor dhe TVSH-në në vlerën e shtuar të arit. Te çështja e shfrytëzimit të tokave, shpejt besoj që do t'ua sjellë në Kuvend Ligjin mbi tatimin mbi Pronë që e adreson këtë çështje në veçanti, për të nxitur pronarët e tokave për të punuar tokat e tyre ose t'i japin me qira në mënyrë që ato të jenë të punueshme. Të hiqet “cash” nga dora pajtohem plotësisht, me Ligjin e ri për Agjencinë e të hyrave që e bëjnë bashkë Administratën tatimore dhe doganore, përveç ndryshimeve administrative bashkimit të këtyre dy agjencioneve ka një varg të reformave që do të vijnë bashkë me këtë. Te rimbursimi, sot është dita e fundit. Sot është kompletuar kjo reformë, është pjesë e pakos së reformës së të bërit biznes, së bashku me Bankën Botërore që kemi është standardizuar procedura, tani me një kërkesë të thjeshtë kryhet rimbursimi i TVSH-së.

Kryetari tha se unë e di që janë marrë masa në administratën tatimore, por mendoj se ende ka nevojë që të rritet efikasiteti i rimbursimit i TVSH-së, është bërë një përparim, por ende ka ankesa të bizneseve dhe kjo zgjat shumë kur lidhet me kontrolla, nuk është dashur që ndoshta domosdoshmërisht rimbursimi i TVSH-së të lidhet me inspekcion dhe kontrolla për arsye se nganjëherë interpretohet jo aq mirë. Por ajo që unë po e shoh, përsosja apo masat e reja ku disa dhënë sugjerime, mendoj se është e gjithë kjo që po ndodh në masat fiskale dhe në masat e tjera, janë të rritura me rritjen ekonomike.

Pas debatit, Komisioni, nxori këtë:

Përfundim

Mbështetet me propozime Pakoja e dytë fiskale.

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në ora 13:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa